



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMISIONI PËR ÇËSHTJE NORMATIVE

**RAPORTI VJETOR I PUNËS
SË KOMISIONIT PËR ÇËSHTJE NORMATIVE PËR
VITIN 2022**

Janar, 2023

A. Tabela e përmbajtjes

1. Tabela e përmbajtjes.....	2
2. Përmbledhje ekskluzive.....	3
3. Plani i punës së Komisionit për Çështje Normative dhe aktet e miratuara në Këshill gjatë vitit 2022 në raport me aktet e tjera normative të miratuara gjatë viteve të fundit.....	5
4. Rregulloret e miratuara në Këshill	9
5. Udhëzimi administrativ dhe udhëzuesit e miratuar në Këshill	20
6. Strategjitë e miratuara në Këshill.....	23
7. Katalogët e pozitive dhe përshkrimit të vendeve të punës për të punësuarit e gjyqësorit të miratuar në Këshill	25
8. Përfundim	27

PËRMBLEDHJE EKSKLUZIVE:

Komisioni për Çështje Normative (tutje: KÇN), është Komisioni i përhershëm i Këshillit, sipas nenit 16 par. pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Me vendimin e Këshillit të datës 28 korrik 2021, KÇN, ka këtë përbërje:

1. Drita Rexhaj – Kryetare e KÇN-së,
2. Qerim Ademaj – anëtar i KÇN-së,
3. Fidan Hoxha –anëtar i KÇN-së,
4. Teuta Ibrahimimi – anëtare rezervë e KÇN-së.

KÇN, në pajtim me nenin 19 par. 3 të Rregullores 03/2020 mbi Organizimin dhe veprimtarin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndër të tjera është përgjegjës për inicimin, përgatitjen dhe hartimin e të gjitha akteve nënligjore dhe politikave të nevojshme për funksionimin e Këshillit dhe gjyqësorit.

Ndërsa, sipas dispozitës së nenit 19 par. 2 po të kësaj rregullore, raporton në Këshill së paku një (1) herë në vit.

Mbi këtë bazë ligjore KÇN, ka përgatitur Raportin vjetor si në vijim:

Bazuar në Planin e Punës dhe vendimeve që kanë dal nga takimet e Këshillit dhe legjislationit në fuqi, përkatësisht ligjit për Gjykatën Komerciale, KÇN është angazhuar maksimalisht gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2022 për përgatitjen, hartimin, shqyrtimin dhe finalizimin e akteve normative, të cilat do t'i paraqesim më poshtë, ka mbajtur njëqind e njëmbëdhjetë takime (111) takime tërë ditore dhe gjashtë (6) punëtori, prej të cilave dy (2) kanë qenë një ditore, ndërsa katër (4) punëtori kanë qenë tre (3) ditore , në të cilat kanë marrë pjesë partnerë vendor dhe ndërkombëtarë.

Anëtarët e KCN përveç takimeve në Komision, kanë qenë të angazhuar në takime dhe punëtori si brenda institucionit ashtu edhe në takime dhe punëtori të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare si përfaqësues të Këshillit sipas kërkesës së Kryesuesit dhe Këshillit.

Në takime dhe punëtori brenda institucionit, anëtarët e KÇN kanë qenë pjesëmarrës në takime të Këshillit, takime të komisioneve të përhershme të Këshillit dhe takime të komisioneve ad hoc të themeluara nga Këshilli. Varësisht nga angazhimi i tyre aktivitet tjera shtesë përveç takimeve të KÇN-së, janë si në vijim:

1. **Drita Rexhaj – Kryetare e KÇN-së** – përveç aktiviteteve në komision, ka qenë pjesëmarrëse në tridhjetë e tetë (38) takime të Këshillit, nga të cilat njëzet e gjashtë (26) takime të rregullta, tetë (8) takime elektronike dhe katër (4) të jashtëzakonshme.

E njëjta ka qenë pjesëmarrëse edhe në dy (2) takime të Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel dhe në tridhjetë e katër (34) takime të komisioneve dhe paneleve ad hoc të themeluara nga Këshilli.

2. **Qerim Ademaj – anëtar i KÇN-së**, përveç aktiviteteve në komision, ka qenë pjesëmarrës në tridhjetë e dy (32) takime të Këshillit, nga të cilat njëzet (20) takime të rregullta, tetë (8) takime elektronike dhe katër (4) të jashtëzakonshme.

I njëjti ka qenë pjesëmarrës në tetëmbëdhjetë (18) takime, përfshirë konferenca, takime dhe punëtori me institucione vendore dhe ndërkombëtare si dhe në njëzet e tetë (28) takime të komisioneve ad hoc të themeluara nga Këshilli.

3. **Fidan Hoxha – anëtar i KÇN-së**, përveç aktiviteteve në komision, ka qenë pjesëmarrës në tridhjetë e tetë (38) takime të Këshillit, nga të cilat njëzet e gjashtë (26) takime të rregullta, tetë (8) takime elektronike dhe katër (4) të jashtëzakonshme.

I njëjti ka qenë pjesëmarrës edhe në gjashtëmbëdhjetë (16) takime në Komisionin për Administrimin e Gjykatave, prej të cilave katërmëdhjetë (14) kanë qenë të rregullta dhe dy (2) të jashtëzakonshme. Ndër të tjera ka qenë pjesëmarrës në dyzet e gjashtë (46) takime në komisionet ad hoc të themeluara nga Këshilli.

Teuta Ibrahimimi – anëtare rezervë e KÇN-së, ka qenë pjesëmarrëse në takimet e KÇN-së në rastet kur ndonjëri nga anëtarët e përhershëm ka qenë me angazhime shtesë dhe nuk ka mundur të jetë pjesëmarrës. Pjesëmarrja e saj në takime posaçërisht veçohet në rastet kur anëtari e përhershëm KÇN-së Fidan Hoxha ka qenë i angazhuar për një kohë të gjatë në Komisionin ad hoc për Vlerësimin e Aplikacionit të Kandidatit për Ekspert Gjyqësor. Gjyqtarja ka qenë e pranishme gjithsej në dyzet (40) takime tërë ditore të KÇN.

PLANI I PUNËS SË KOMISIONIT PËR ÇESHTJE NORMATIVE DHE AKTET E MIRATUARA NË KËSHILL GJATË VITIT 2022 NË RAPORT ME AKTET E TJERA NORMATIVE TË MIRATUARA GJATË VITEVE TË FUNDIT

Komisioni për Çështje Normative, në pajtim me Planin e punës së Këshillit për vitin 2022 dhe objektivat strategjike të mbështetura në Strategjinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitet 2020-2022, ka hartuar dhe miratuar planin e punës së tij. KÇN në plan të punës së tij ka paraparë gjithsejtë njëzet e një (21) akte normative për hartim, shqyrtim dhe miratim, prej të cilave trembëdhjetë (13) rregullore, tri (3) rregullore për ndryshim dhe plotësim të rregullores bazë, një (1) udhëzim administrativ për ndryshim dhe plotësim të udhëzimit administrativ bazë, dy (2) udhëzues, katalogun të pozitive dhe përshkrimit të vendeve të punës për të punësuarit e gjyqësorit dhe një manual.

KÇN, gjatë këtij viti është angazhuar maksimalisht në përmbushjen e obligimeve të cilat i ka marr përmes planit të punës së tij, vendimeve të Këshillit dhe kërkesave ligjore, ka finalizuar dhe i ka rekomanduar për miratim gjithsejtë njëzet e katër (24), akte normative, dhe atë: pesëmbëdhjetë (15) rregullore prej të cilave dy (2) rregullore janë për plotësimin dhe ndryshim të rregullores dy (2) rregulloreve bazë, një (1) udhëzim administrativ për ndryshim dhe plotësim të udhëzimit administrativ, katër (4) udhëzues, dy (2) strategji, katalogun e pozitive dhe përshkrimit të vendeve të punës për të punësuarit e gjyqësorit dhe një (1) plotësim/ndryshim të katalogut bazë. Në kuadër të këtyre akteve KÇN, ka finalizuar edhe 97 shtojca dhe një nga këto shtojca përmban në vete tetëmbëdhjetë (18) formular. Të gjitha këto akte së bashku me shtojcat janë miratuar në Këshill.


Për shkak të dinamikave dhe prioriteteve të dala në Këshill gjatë vitit 2022, KÇN-së i kanë mbetur edhe tetë (8) akte normative pa i finalizuar dhe rekomanduar për miratim në Këshill, të cilat janë bartë për vitin 2023.

Edhe për kundër asaj se KÇN nuk ka mundur të përmbush realizimin e objektivave të cilat i ka paraparë sipas planit të punës, i njëjti sipas vendimeve të Këshillit dhe autorizimeve ligjore, përkatësisht Ligjit për Gjykatën Komerciale ka finalizuar dhe rekomanduar për miratim në Këshill edhe njëmbëdhjetë (11) akte normative, jashtë planit të punës nga të cilat: pesë (5) rregullore, një (1) udhëzim administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ, dy (2) udhëzues, një (1) ndryshim dhe plotësimi katalogut bazë dhe dy (2) strategji të cilat në vete ngërthejnë edhe planin e veprimit për realizimin e strategjisë, numër i akteve i cili e ka tejkaluar edhe objektivat e parapara nga vet KÇN.

Figura1: Aktet normative gjatë vitit 2022 të paraqitura në formë tabelore

viti	Numëri i akteve normative sipas planit të punës	Numëri i akteve normative finalizuara dhe të rekomanduara në Këshill sipas planit të punës	Numëri i akteve normative të finalizuara sipas vendimeve të Këshillit dhe legjislacionit në fuqi	Numëri i akteve normative të mbetura jashtë realizimit të planit të punës	Gjithsejt akte normative të finalizuara dhe të rekomanduara për miratim në Këshill
2022	21	13	11	8	24

Figura 2: Aktet normative gjatë vitit 2022 të paraqitura në grafikone



Më tej, KÇN gjatë këtij viti përveç akteve që ka finalizuar dhe rekomanduar për miratim në Këshill, ka proceduar në konsultim publik dy (2) rregullore si dhe ka shqyrtuar dhe ka arritur deri në fazën e finalizimit të Katalogut të pozitive dhe përshkrimit të vendeve të punës për të punësuarit e Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Katalogut të pozitive dhe përshkrimit të vendeve të punës për të punësuarit e Njesisë të Inspektimit Gjyqësor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.


Tregues për angazhimin maksimal të KÇN, është numri i madh i takimeve dhe punëtorive që ka organizuar për hartim, shqyrtim dhe finalizim të akteve normative.

Tregues matës tjetër është edhe krahasimi i akteve normative të miratuara nga KCN në pesë vitet e fundit, përkatësisht viti 2018-2022, i paraqitur në mënyrë tabelore sipas llojit të aktit normativ për secilin vit, e të cilat janë me sa vijon më poshtë:

Figura 3: krahasimi i akteve normative të miratuara nga KÇN në pesë (5) vitet e fundit, përkatësisht viti 2018-2022 në formë tabelore.

Viti	Rregullore	Rregullore për ndryshim dhe plotësim te rregullores	Udhëzime administrative	Udhëzim administrativ për ndryshim dhe plotësim të udhëzimit administrativ	Udhëzues	Strategji	Katalog	Gjithsej aktet e miratuara gjatë viteve
2018	1		1					2
2019	9		4		2			15
2020	4		2			1		7
2021	7		3		1			11
2022	13	2		1	4	2	2	24

Figura 4: krahasimi i akteve normative të miratuara nga KÇN në pesë (5) vitet e fundit, përkatësisht viti 2018-2022 në grafikone.



Komisioni ka hartuar edhe Planin e Punës për vitin 2023, i cili ka prioritet hartimin dhe rekomandimin për miratim të një mori aktesh normative, të cilat do të lehtësojnë punën e Këshillit dhe gjyqësorit në përgjithësi.

RREGULLORET E MIRATUARA NË KËSHILL

Rregulloret e shqyrtuara, të finalizuara dhe të rekomanduara për miratim, e të cilat janë miratuara në Këshill për periudhën janar- dhjetor të vitit 2023 janë si në vijim:

1. **Rregullore Nr.01/2022 për Themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore-** përcakton rregullat për themelimin dhe funksionimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore dhe procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve të Komitetit.

Komiteti Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore i themeluar sipas kësaj rregullore nga ana e Këshillit qëllim kryesor do të ketë që të ndihmoj gjyqtarët me informacione, këshilla dhe opinionë rreth pyetjeve apo çështjeve etike të identifikuara për interpretim në lidhje me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë dhe Ligjit të Procedurës Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Sipas kësaj rregullore, Komiteti është themeluar në atë mënyrë që do të shërbejë si platformë ku gjyqtarët mund të këshillohen si t'i trajtojnë situatat apo sjelljet e ardhshme të cilat mund të konsiderohen në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë.

2. **Rregullore Nr. 02/2022 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr.07/2019 për Certifikimin e Interpretëve dhe Përkthyesve Gjyqësor: dhe tetë (8) shtojcat -** me këtë ndryshim - plotësim të rregullores është bërë tejkalimi i dilemave dhe vështirësive të cilat janë hasur gjatë zbatimit të rregullores bazë në praktikë. Janë riformuluar disa nene të cilat kanë rregulluar dhe qartësuar situata konkrete duke përcaktuar kriterë të qarta për secilin rast, e ndër të tjera janë përcaktuar edhe kriteret për të emëruar anëtarët e Komisionit për Testimin dhe Vlerësimin e Kandidateve për certifikim të përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor, mungesa e të cilave ka pamundësuar emërimin e këtij komisioni me rregulloren bazë.

Me këtë rregullore është bërë riformulimi i dispozitave kalimtare dhe përfundimtare me ç 'rast është paraparë afati prej një viti për përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor të certifikuar më parë me aktvendime nga ish Gjykatat e Qarkut që të përfshihen në listën e re të përkthyesve dhe interpretëve gjyqësorë.

Po ashtu, është paraparë mënyra e aplikimit dokumentet që secili kandidatë duhet t'i paraqes në mënyrë që të përfshihet në listën e re të përkthyesve dhe interpretëve gjyqësorë, si dhe themelimi i Komisionit ad hoc për verifikimin e dokumentacionit të përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor të certifikuar më parë me aktvendime nga ish Gjykatat e Qarkut. Ndërsa tetë (8) shtojca si pjesë përbërëse të rregullores, lehtësojnë punën e të gjithë zbatuesve të kësaj rregullore dhe rregullores bazë.

3. **Rregullore Nr. 03/2022 për Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet dhe Shpërblimin e Ekspertëve Gjyqësor dhe pesë (5) shtojcat:-** Edhe pse Këshilli me 10 nëntor 2015 ka miratuar rregulloren 15 /2015 për emërim e eksperteve gjyqësor, kjo rregullore nuk ka mundur të zbatohet në praktikë.

Pas ndryshimeve legjislative në lidhje me gjyqësorin, ky problem është tejkaluar dhe përmes ligjit për gjykatat i është lenë e drejtë ekskluzive këshillit e drejta e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet dhe Shpërblimi i Ekspertëve Gjyqësor.

KÇN, i ka dhënë prioritet kësaj rregullore duke pasur parasysh nevojën e krijuar në sistemin gjyqësor të vendit tonë, ku për nëntë (9) vite radhazi asnjë ekspert gjyqësor nuk është licencuar, listat e eksperteve nuk kanë qenë të definuara. Poashtu, për tërë këtë periudhe kohore, listat e ekspertëve gjyqësor asnjëherë nuk është spastruar për t'u evidentuar dhe larguar ekspertët gjyqësor të cilët kanë vdekur apo iu është heqë zotësia për të vepruar ose për ndonjë arsye tjetër nuk kanë mundur ta ushtrorjnë detyrën e ekspertit. Ndër të tjera, për përpilimin e listave të eksperteve gjyqësor nuk janë përdorur kritere apo nëse edhe janë përdorur në raste të caktuara kanë qenë minimale.

Rregullorja përcakton procedurat e emërimit dhe certifikimit për ekspertët e interesuar nga Këshilli, të drejtat dhe detyrimet, kompensimin e ekspertëve gjyqësor, procedurën e certifikimit të eksperteve të emëruar nga institucionet kompetente sipas legjislacionit në fuqi, kompensimin e ekspertëve gjyqësor të institucioneve publike, pezullimin e ekspertit gjyqësor dhe revokimi i certifikatës dhe largimin nga lista e ekspertit gjyqësor pesë (5) shtojcat si pjesë përbërëse rregullores, lehtësojnë punën e të gjithë zbatuesve të kësaj rregullore.

Shtojca 4 dhe 6 e rregullores, është miratuar me vendimin e Këshillit, me numër KGJK.nr. 399/2022, të datës 20 tetor 2022, ndërsa shtojca 5 është miratuar me vendimin e Këshillit me numër KGJK.nr. 471/2022, të datës 14 dhjetor 2022, të njëjtat përcaktojnë listën e shërbimeve të cilat ofrohen me pagesë institucionet publike dhe të specializuar.

- 4. Rregullore Nr.04/2022 për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes dhe Themelimin e Marrëdhënies së Punës për Administratore të Gjykatave dhe tetë (8) shtojcat** - përcakton rregullat dhe procedurat e rekrutimi, përzgjedhjes dhe themelimit të marrëdhënies së punës së administratorëve në gjykatat e Republikës së Kosovës, që përfshinë por nuk kufizohet me: shpalljen publike të pozitës për vende të lira; hartimin, vlerësimin, organizimin dhe administrimin e provimit; themelimin, kompetencat dhe mandatin e Komisionit për Rekrutim, Komisionit për Rishqyrtim; si dhe procesin e verifikimit dhe vlerësimit të integritetit personal e profesional.

Ndërsa, tetë (8) shtojca si pjesë përbërëse të rregullores, lehtësojnë punën e të gjithë zbatuesve të kësaj rregullore.

- 5. Rregullore Nr. 05/2022 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 07/2017 për Organizimin dhe Funksonimin e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës-** kërkesa ligjore, përkatësisht Ligji për Gjykatën Komerciale dhe iniciativa e marrë nga Asambleja e Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës kanë determinuar në ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores bazë Nr. 07/2017 për Organizimin dhe Funksonimin e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave.

Në këtë rregullore është paraparë që takimet e Asamblesë së kryetarëve të gjykatave të mbahen të paktën çdo tre (3) muaj apo katër (4) herë në vit. Për takimet anëtarët e asamblesë të njoftohen si me takimin ashtu edhe me përbërjen e agjendës dhe mundësisë për propozimet në agjendë në një afat optimal kohor.

Meqenëse në rregullorën bazë është paraparë mandati i anëtarëve të asamblesë dhe kryesuesit të asamblesë, me rregullorën për ndryshimin dhe plotësimin e rregullorës bazë është paraprë edhe mandati i zëvendës kryesuesit dhe kompetencat e tij. Poashtu,

rregullorja, ka paraparë që pjesë e asamblesë të jetë edhe kryetari i Gjykatës Komerciale.

- 6. Rregullore Nr. 06/2022 për Organizimin dhe Funkcionimin e Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe shtojca** - përcakton organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si njësi e themeluar në kuadër të Këshillit, me qëllim të ofrimit të mbështetjes profesionale dhe administrative për Këshillin, njësitë e Këshillit dhe gjykatat, siç përcaktohet me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Me këtë rregullore përveç ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi të Sekretariatit, definohet struktura e secilit departament, divizion dhe zyrë që ushtron fushëveprimtarinë e tij në Sekretariatit, në mënyrë që të lehtësohet puna e përditshme brenda tij.

Rregullorja përcakton konkretisht mënyrën dhe nivelin e raportimit brenda departamenteve, divizioneve dhe zyrave, si dhe llogaridhënien dhe përgjegjësitë e stafit, procesin e vlerësimit të performancës së stafit administrativ në Sekretariat.

Përmes kësaj rregullore është synuar të funksionalizohet menaxhimi i brendshëm i Sekretariatit me qëllim të rritjes së transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies.

Në shërbim të rritjes së transparencës, rregullores i është bashkangjitur organogrami si shtojcë përcjellëse, i cili njëkohësisht është edhe pasqyrim i rregullores.

- 7. Rregullore Nr. 07/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Komerciale dhe shtojca** - me qëllim të përmbushjes së kërkesës ligjore, përkatësisht Ligjit për Gjykatën Komerciale për funksionalizimin e Gjykatës Komerciale është miratuar. Rregullorja përcakton rregullat lidhur me organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Gjykatën Komerciale. Po ashtu me këtë rregullore, është përcaktuar edhe juridiksioni i Gjykatës Komerciale dhe organizimi në Dhomat e shkallës së parë dhe Dhomat e shkallës së dytë, në kuadër të të cilave veprojnë departamentet si dhe divizioni për investitorët e huaj. Është përcaktuar struktura organizative e gjykatës, numri i pozitave udhëheqëse dhe varëse me qëllim të lehtësimit të punës së përditshme të gjykatës.

Rregullorja përcakton mënyrën dhe nivelin e raportimit brenda departamenteve, divizioneve dhe zyrave, si dhe llogaridhënien dhe përgjegjësitë e stafit, procesin e vlerësimit të performancës së stafit administrativ në gjykatë.

Përmes kësaj rregullore është synuar të funksionalizohet menaxhimi i brendshëm i Gjykatës Komerciale me qëllim të rritjes së transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies.

Në shërbim të rritjes së transparencës, rregullorës i është bashkangjitur organogrami si shtojcë përcjellëse, i cili njëkohësisht është edhe pasqyrim i rregullores.

- 8. Rregullore Nr.08/2022 për Transferimin e Gjyqtarëve dhe shtojca:-** përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat e transferimit të një gjyqtari nga gjykata transferuese në gjykatën e transferimit, të të njëjtit nivel me qëllim të menaxhimit efikas dhe administrimit efektiv të drejtësisë, për të trajtuar në kohë të arsyeshme dhe në mënyrë proporcionale lëndët brenda sistemit gjyqësor.

Me këtë rregullore është përcaktuar procedura, rrethanat dhe kriteret për transferim të rregullt, jashtëzakonshëm dhe të përhershëm. Po ashtu janë paraparë edhe rastet specifike të angazhimit të gjyqtarit të transferuar ku sipas nevojës të gjykatës apo degës përkatëse në të njëjtën kohë gjyqtari mund të punoj në gjykatën transferuese dhe në gjykatën e transferimit.

Po ashtu tek transferimi i përhershëm është paraparë një dispozitë kohëzgjatja e veprimit të së cilës rregullohet tek dispozitat kalimtare të rregullores, e cila e autorizon Këshillin që për nevoja dhe shkaqe të arsyeshme mund të transferoj edhe një kandidatë gjyqtar me mandat fillestar por me kusht që i njëjti të ketë të përfunduar trajnimin fillestar. Shtojcë e kësaj rregullore është formulari i aplikimit për transferim të përhershëm të gjyqtarit.

- 9. Rregullore Nr.09/2022 për rekrutimin dhe emërimin e Këshilltarit Ligjor në Gjykatën Komerciale dhe katër (4) shtojcat-** përcakton procesin e rekrutimit dhe emërimit të këshilltarit ligjor në Gjykatën Komerciale. Miratimin e rregullores e kanë determinuar kërkesat ligjore, përkatësisht Ligji për Gjykatën Komerciale, i cili ka

paraparë një strukturë organizative të Gjykatës Komerciale e cila dallon nga struktura e brendshme organizative e gjykatave të tjera të Republikës së Kosovës.

Ligji pozitën e këshilltarit ligjor, e ka paraparë si pozitë e nivelit drejtues, i cili është përgjegjës për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e Njesisë Ligjore në Gjykatën Komerciale, e cila dallon nga pozitat e tjera udhëheqëse në administratën gjyqësore: pasi që nuk ekziston si pozitë në asnjë gjykatë tjetër, shpallet me njoftim të brendshëm përmes shprehjes së interesit për aplikim dhe se të drejtë aplikimi për këtë pozitë kanë ~~vetëm~~ bashkëpunëtorët profesional të cilët punojnë në Gjykatën Komerciale. Ndërsa katër (4) shtojcat si pjesë përbërëse rregullore, lehtësojnë punën e të gjithë zbatuesve të kësaj rregullore.

10. Rregullore Nr.10/2022 për Procedurën Disiplinore për Anëtarët e Këshillit

Gjyqësor të Kosovës- përcakton rregullat për procedurën disiplinore të anëtarëve të Këshillit, duke i përfshirë në mënyrë të përgjithshme procedurën e hetimit të anëtarit të Këshillit, procedurën e pezullimit të anëtarit dhe rekomandimit për shkarkim të anëtarit.

Më tej, me rregullore janë paraparë rastet / shkeljet disiplinore kur anëtari i Këshillit i nënshtrohet procedurës disiplinore, sanksionet disiplinore që mund të shqiptohen anëtarit të Këshillit në rast të shkeljeve disiplinore, veprimet procedurale të Këshillit pas shqyrtimit fillestar të ankesës, fillimin e hetimit disiplinor dhe komisioni disiplinor.

Tutje, rregullorja ka paraparë të gjitha veprimet gjatë procedurës disiplinore si: zhvillimin e seancës dëgjimore, këshillimin dhe votimin, hartimin e raportit nga komisioni disiplinor, si dhe procedurën e veprimit të Këshillit ndaj rekomandimit të komisionit për masat disiplinore të propozuara përfshirë shkarkimin e anëtarit të Këshillit qoftë i zgjedhur nga gjyqësori apo Kuvendi i Republikës së Kosovës.

11. Rregullore Nr. 11/2022 për Evidencën penale të Republikës së Kosovës dhe njëmbëdhjetë (11) shtojcat- me këtë rregullore në mënyrë të tërësishme rregullohet, mbajtja, menaxhimi dhe distribuimi i të dhënave penale të personave të dënuar me aktgjykime të plotfuqishme gjyqësore në nivel të Republikës së Kosovës.

Kjo rregullore, përcakton mekanizmat përgjegjëse në Këshill dhe Gjykata, për menaxhimin e evidencës penale. Rregullorja përcakton procedurat e regjistrimit të të dhënave penale në Sistemin Qendror të Evidencës Penale, duk përcaktuar llojin e të dhënave të cilat do të mbahen në mënyrë të centralizuar në sistemin e evidencës penale.

Gjithashtu, rregullorja përcakton mënyrën e ofrimit të shërbimeve të evidencës penale për palët dhe institucionet, si dhe rregullon edhe procedurën e fshirjes së dënimeve nëpërmjet procesit të rehabilitimit ligjor. Ndërsa, njëmbëdhjetë (11) shtojca si pjesë përbërëse të rregullores, lehtësojnë punën e të gjithë zbatuesve të kësaj rregullore.

12. Rregullore Nr. 12/2022 për Procedurën e Zgjedhjes, Emërimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës dhe katër (4) shtojca - është miratuar me qëllim të rritjes së llogaridhënies dhe efikasitetit në sistemin gjyqësor.

Procedurës së hartimit, shqyrtimit, finalizimit në KCN si dhe miratimit në Këshill të kësaj rregullore i kanë paraprirë arsyet, si në vijim:

- Ndryshimet e shumta që i ka pasur ndër vite rregullorja bazë, kanë qenë katër (4) ndryshim-plotësime të rregullores; dhe,
- vlerësimi i performancës së kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës të rregullohet me një akt të veçantë nënligjor.

Rregullorja përcakton procedurat për procesin e zgjedhjes, emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës. Rregullorja ngërthen në vete disa risi:

- Në pajtim me Ligjin për Gjykatën Komerciale, tek kriteret formale kualifikuese për aplikim është përcaktuar një kriter i veçantë që dallon prej kritereve për emërim të kryetarëve të gjykatave, kandidati për kryetar të Gjykatës Komerciale, duhet të plotësoj kriterin themelor, të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune si gjyqtar i shkallës së dytë;
- vlerësimi i kandidatëve është paraparë në pikë të caktuara për secilën kategori;
- për kryetar të gjykatës mund të rekomandohet në Këshill vetëm kandidati që në rezultatin përfundimtar të procesit vlerësues ka arritur së paku shtatëdhjetë (70)

pikë, nga njëqind (100) pikët sa janë të mundura sipas përcaktimit me këtë rregullore;

Rregullorja parasheh që zgjedhja dhe emërimi i kryetarit të gjykatës dhe gjyqtarit mbikëqyrës të bëhet përmes një procesi të hapur, konkurrues, transparent dhe meritore, siç përcaktohet me ligj, duke përjashtuar çfarëdo lloj diskriminimi. Ndërsa, katër (4) shtojca si pjesë përbërëse të rregullores, lehtësojnë punën e të gjithë zbatuesve të kësaj rregullore.

13. Rregullore Nr. 13/2022 për Vlerësimin e Performancës të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës dhe pesë (5) shtojca - rregullon procedurën e vlerësimit të performancës së kryetarëve të gjykatave dhe të gjyqtarëve mbikëqyrës.

Arsyeja e hartimit, finalizimit dhe propozimit për miratim në Këshill të kësaj rregullore ka qenë se me Rregulloren Nr.09/2016 për procedurat e zgjedhjes, emërimin, vlerësimin, pezullimit dhe shkarkimit të kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës në fuqi, është vetëm një kapitull cili i referohet vlerësimit të performancës së kryetarëve të gjykatave, ndërsa vlerësimin e performancës së gjyqtarëve mbikëqyrës e ka anashkaluar. Edhe pse kapitulli i është referuar vlerësimit të performancës së kryetarëve të gjykatave, procedura nuk ka qenë mjaft e detajuar dhe ka hasur në vështirësi të zbatohet në praktikë.

Me këtë rregullore përcaktohen parimet, procedura, kriteret dhe rregullat lidhur me vlerësimin e performancës së kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës.

Gjithashtu, me këtë rregullore synohet që përmes vlerësimit të performancës së kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës, të bëhet ngritja e efikasitetit dhe llogaridhënies në sistemin gjyqësor, promovimi i profesionalizimit, shkathtësisë dhe përgjegjësisë së kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës, nxitja në arritjen e rezultateve të mira të punës në gjykata dhe degë si dhe në drejtim të ngritjes së besimit të publikut në punën e gjykatave.

Rregullorja parasheh disa risi në hapat që ndërmerren për vlerësimin e performancës së kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës, e të cilat janë si në vijim:

- Në komisionin për vlerësim të performancës së gjyqtarëve janë paraparë anëtarët rezervë në rast të konfliktit të interesit të anëtarëve të rregullt apo për arsye objektive, ndërsa vlerësimi i performancës së gjyqtarëve mbikëqyrës është paraparë të bëhet nga kryetari i gjykatës;
- Periudha e vlerësimit të performancës është paraparë të bëhet për vlerësimin e parë jo më vonë se tridhjetë (30) muaj pas marrjes së mandatit, ndërsa vlerësimi i dytë jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas përfundimit të mandatit;
- Për vlerësim të performancës së kryetarëve të gjykatave janë shtuar nën kritere të reja për vlerësim, ndërsa për gjyqtarët mbikëqyrës janë paraparë kritere dhe nën kritere në bazë të të cilave do të vlerësohen, e të cilat janë të ngjashme me kriteret dhe nën kriteret për kryetar të gjykatave.
- Janë përcaktuar burimet e informacionit dhe shkallët e vlerësimit për vlerësimin e performancës së kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës;
- është definuar mënyra e veprimit të Këshillit lidhur me ankesën dhe është specifikuar se për rastet kur Këshilli e miraton ankesën, procesi i ri vlerësimit kryhet nga ana e Këshillit, jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë, duke llogaritur nga dita kur është aprovuar ankesa e subjektit të vlerësimit.

Ndërsa, pesë (5) shtojcat si pjesë përbërëse të rregullores, lehtësojnë punën e të gjithë zbatuesve të kësaj rregullore.

14. Rregullore Nr. 14/2022 për Organizimin dhe Funkcionimin e Njesisë për Inspektim Gjyqësor dhe shtojca- përcakton organizimin dhe funksionimin e Njesisë për Inspektim Gjyqësor, si njësi e veçantë organizative në kuadër të Këshillit, me qëllim të ofrimit të mbështetjes profesionale dhe administrative për Këshillin dhe komisionet përkatëse, siç përcaktohet me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Rregullorja është strukturuar në atë mënyrë që përveç organizimit të brendshme në tre zyra, rregullon edhe funksionimin e Njesisë duke përfshirë fushë -veprimtarin e Njesisë dhe të secilës Zyrë.

Rregullorja përcakton edhe përgjegjësinë dhe raportimin e të gjithë zyrtarëve të Njesisë, duke përfshirë drejtoret e zyrave dhe të punësuarit e tjerë në kuadër të zyrave.

Më tej, rregullorja përcakton mënyrën se nga kush bëhet vlerësimi i performacës duke filluar nga drejtoret e zyrave deri tek të gjithë të punësuarit e tjerë në kuadër të zyrave.

Në shërbim të rritjes së transparencës, rregullores i është bashkangjitur organogrami si shtojcë përcjellëse, i cili njëkohësisht është edhe pasqyrim i rregullores.

15. Rregullore Nr. 15/2022 për Statusin, të Drejtat, Detyrimet, Performancën, Disiplinimin, Transferimin, Trajnimet dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës të Bashkëpunëtorit Profesional dhe tri (3) shtojca - është miratuar me qëllim të forcimit të efikasitetit, llogaridhënies dhe performancën së gjyqësorit, derivon nga Rregullorja Nr. 04/2021 për Procedurën e Rekrutimit dhe Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional, me qëllim të rregullimit të statusit, të drejtave, detyrimeve, vlerësimin e performancës, procedurën e disiplinimit si dhe përfundimin e marrëdhënies së punës të bashkëpunëtorëve profesional.

Rregullorja përcakton statusin, të drejtat, detyrimet, procedurën e vlerësimit të performancës, procedurën e disiplinimit, transferimit, trajnimet dhe përfundimin e marrëdhënies së punës së bashkëpunëtorit profesional.

Sipas rregullores procedura e ushtrimit të detyrave përcaktohet sipas standardeve profesionale, ndërsa procedura e vlerësimit të performancës përbën një përmbledhje të rezultateve në punë përfshirë progresin dhe procedurat e vlerësimit të rezultateve në punë si dhe të drejtën e ankesës.

Rregullorja përcakton edhe autoritetet kompetente për vlerësimin e performacës së bashkëpunëtorit profesional në gjykata dhe Sekretariat, gjatë periudhës provuese.

Rregullorja përcakton të gjitha llojet e pushimit të bashkëpunëtorit profesional, përfshirë: pushimin vjetor, mjekësor, pushimin e lehonisë, të drejtën e shfrytëzimit të këtyre pushimeve si dhe të drejtën në mungesë nga puna me pagesë.

Rregullorja si akt tejet i rëndësishëm për bashkëpunëtorët profesional, poashtu përcakton edhe trajnimet dhe mënyrat e transferimit të bashkëpunëtorit profesional,

procedurën e përgjegjësive disiplinore në rast të shkeljeve eventuale të bashkëpunëtorëve profesional, klasifikimi e shkeljeve disiplinore, procedurat për shkeljet e rënda dhe të lehta, masat disiplinore, kompetencën për zbatimin e këtyre masave, si dhe pezullimin dhe ndërprerjen për marrëdhënien e punës.

Ndërsa, tri (3) shtojca si pjesë përbërëse të rregullores, lehtësojnë punën e të gjithë zbatuesve të kësaj rregullore

UDHËZIMI ADMINISTRATIV DHE UDHËZUESIT E MIRATUAR NË KËSHILL

KÇN për periudhën raportuese janar- dhjetor të vitit 2022, përveç rregulloreve të listuara në këtë raport, ka hartuar, finalizuar dhe rekomanduar për miratim edhe një (1) udhëzim administrativ për ndryshim dhe plotësim të udhëzimit administrativ, katër (4) udhëzues. Udhëzimi administrativ dhe udhëzuesit e finalizuar janë miratuar në Këshill dhe janë si në vijim:

- 1. Udhëzim Administrativ nr.01/2022 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr.01/2022 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 04/2019 për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara-** kërkesa ligjore, përkatësisht Ligji për Gjykatën Komerciale dhe iniciativa e KÇN kanë determinuar në ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr.01/2022 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 04/2019 për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara.

Në këtë udhëzim administrativ i mundësohet Gjykatës Komerciale, që përveç publikimit të aktgjykimeve, siç është paraparë me udhëzimin administrativ bazë, të publikoj edhe të gjitha aktvendimet e dhomave të shkallës së dytë dhe aktvendimeve meritore të dhomave të shkallës së parë.

- 2. Udhëzues themelore i referimit për trupat para-hetuese dhe hetuese në kryerjen e hetimeve në çështjet disiplinore gjyqësore dhe tri (3) shtojca e 18 formularë-** ka për qëllim të jetë mjet praktik për përdorim nga Autoritetet Kompetente dhe Panelet Hetimore, të themeluara nga Këshilli për kryerjen e hetimeve në çështjet disiplinore gjyqësore. Është hartuar kryesisht për të ndihmuar Panelet Hetimore që kryejnë aktivitetet rutinore hetimore, ashtu që hetimet disiplinore të zhvillohen në mënyrë të drejtë dhe në kohën e duhur, si dhe ashtu që e drejta e gjyqtarit për proces të rregullt të respektohet gjatë fazës hetimore.

Udhëzuesi kryesisht thekson rolin dhe funksionin e Paneleve Hetimore, nuk synon të adresojë të gjitha çështjet procedurale që përbëjnë një rast disiplinor, qoftë në procedurë para-hetimore apo hetimore. Udhëzuesi fokusohet kryesisht tek faza hetimore e procesit disiplinor, janë dhënë edhe informata më të gjera mbi procesin disiplinor gjyqësor të Kosovës dhe standardet ndërkombëtare, si referenca. Përbëhet nga shtatë(7) pjesë ku: ofron një pasqyrë të shkurtër të kornizës ligjore për procedurën disiplinore gjyqësore të

Kosovës (*Pjesa 2*), përmban informata mbi praktikat e mira ndërkombëtare, relevante për një sistem disiplinor gjyqësor, e të cilat mund të jenë me interes për anëtarët e Panelit (*Pjesa 3*), ofron një analizë, të ndarë në hapa, të fazës para-hetimore (*Pjesa 4*), përmban një analizë të detajuar të procedurës së hetimit dhe praktikat e mira të rekomanduara, (*Pjesa 5*), trajton të drejtat e subjektit të hetimit në proces të rregullt gjykimi (*Pjesa 6*), përqendrohet në zgjidhjen vullnetare të rastit disiplinor, në përputhje me marrëveshjen midis Panelit Hetimor dhe subjektit të hetimit (*Pjesa 7*). Udhëzuesi ka tri (3) shtojca. Shtojcës një (1) i janë bashkangjitur tetëmbëdhjetë (18) formularë standard për lehtësimin e punës të të gjithë zbatuesve të këtij udhëzuesi, shtojca dy (2) ka të bëjë me grafiket e sistemit disiplinor, ndërsa shtojca tre (3) flet për standardet dhe praktikat ndërkombëtare në sistemet disiplinore.

3. **Udhëzuesi për transferimin e lëndëve në Gjykatën Komerciale dhe katër (4) shtojcat e tij**- përcakton saktësimin e procedurës së transferimit të lëndëve nga gjykatat e Republikës së Kosovës në Gjykatën Komerciale, të themeluar sipas Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, duke shërbyer si një udhëzues unifikues për gjykatat e Republikës së Kosovës në procesin e transferimit të lëndëve.

Udhëzuesi do të shërbejë si një ndihmesë për Gjykatat në identifikimin e lëndëve të përshtatshme për transferim dhe ka për qëllim të lehtësojë procesin e transferimit të lëndëve nga gjykatat në mënyrë që në detaje të qartësoj procesin e transferimit dhe veprimet që duhet të ndërmerren nga secila Gjykatë. Udhëzuesi ka një shtojcë të cilës i janë bashkangjitur katër (4) formularë standard për lehtësimin e punës të të gjithë zbatuesve të këtij udhëzuesi.

4. **Udhëzues për procedurën e dërgimit të shkresave nga Gjykata dhe njëzet e shtatë (27) shtojcat**- përcakton saktësimin e procedurës dhe ndërmarrjes së veprimeve për dorëzimin/ dërgimin e shkresave nga gjykata tek pala në procedurë / marrësi i saj, si përmes dorëzuesit ashtu edhe përmes postës.

Këshilli me qëllim të realizimit të përgjegjësive të tij për një organizim, menaxhim, administrim dhe mbikëqyrje të funksionimit sa më të mirë të gjykatave sipas ligjit, inicioj procedurën për hartimin, finalizimin dhe miratimin e Udhëzuesit për Procedurën e Dërgimit të Shkresave nga Gjykata dhe shtojcave të tij.

Udhëzuesi do t'iu shërbejë gjykatave, përkatësisht zyrtarit përgjegjës të gjykatës /dorëzuesit i cili merret me shpërndarjen e shkresave të gjykatës tek pala / marrësi i saj që ka për qëllim të lehtësoj punën në praktikë, duke siguruar procedura të qarta lidhur me dorëzimin e shkresave përshtatshëmrisht me këtë udhëzues dhe legjislacionin në fuqi. Udhëzuesi ka njëzet e shtatë (27) shtojca të cilit i janë bashkangjitur për lehtësimin e punës të të gjithë zbatuesve të këtij udhëzuesi.

5. **Udhëzues për Hartimin dhe Konsultimin Publik të Akteve Normative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dy (2) shtojca dhe pesë (5) forma** – është hartuar, shqyrtuar dhe rekomanduar për miratim në Këshill me qëllim të ngritjes së transparencës në gjyqësor dhe përfshirjes së të gjithë akterëve në procesin e hartimit të akteve normative në Këshill.

Udhëzuesi përcakton rregullat e unifikuara të teknikës juridike, të hartimit të akteve normative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përmes së cilit janë përcaktuar rregullat e formës dhe përmbajtjes së akteve normative, si dhe i gjithë procesi i hartimit që nga fillimi e deri në miratimin e aktit.

Me qëllim të zbatimit të plotë udhëzuesit dhe zbatimit të rregullave të unifikuara të teknikës juridike të akteve normative janë hartuar edhe dy (2) shtojca dhe pesë (5) forma të cilit i janë bashkangjitur për lehtësimin e punës të të gjithë zbatuesve të këtij udhëzuesi.

STRATEGJIT E MIRATUARA NË KËSHILL

KÇN, përveç finalizimit dhe rekomandimit të akteve normative të më sipërme ka hartuar, shqyrtuar, finalizuar dhe rekomanduar për miratim dy (2) strategji , të cilat janë miratuar në Këshill.

Strategjitë e miratuara janë si në vijim:

- **Strategjia e Komunikimit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (2022 -2024) dhe plani i veprimit për zbatimin e Strategjisë se Komunikimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës** - është hartuar për të siguruar që të gjitha synimet dhe objektivat e komunikimit të mbështesin aftësinë e gjyqësorit për të përmbushur dhe tejkaluar synimet institucionale. Si vazhdim dhe përditësim i Strategjisë së Komunikimit 2014-2019, kjo strategji është bazuar në mësimet e nxjerra dhe synon ngritjen e kapaciteteve të Këshillit dhe gjykatave.

Si plan i standardizuar dhe i strukturuar për zyrën e komunikimit në Këshill dhe gjykata, strategjia 2022-2024 synon të përkufizoj forcimin e marrëdhënieve në mes të gjyqësorit, partnerëve vendor dhe ndërkombëtar, shoqërisë civile dhe publikut, duke hartuar dhe zbatuar këtë plan strategjik të komunikimit. Këshilli mbetet i përkushtuar të veproj në mënyrë transparente, duke siguruar që media dhe publiku të jenë plotësisht të informuar në gjyqësor. Ky plan mund të përditësohet sipas nevojave të KGJK-së dhe gjykatave.

Synimi i përgjithshëm i kësaj Strategjie është të ofrojë një udhërrëfyes nëpërmjet të së cilit gjyqësori i Kosovës do të rrisë besimin e qytetarëve, të krijojë mirëkuptim lidhur me qasjen e qytetarëve në drejtësi dhe të sigurojë që gjyqësori mbetet i angazhuar me qytetarët për të kuptuar dhe adresuar më mirë sfidat me të cilat përballen. Synimet dhe objektivat e shënuara në strategji do të arrihen me veprimet dhe nismat e përshkruara në Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë.

1. **Plani Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025, Efikasiteti dhe Prioritizimi i Lëndëve Brenda Sistemit Gjyqësor dhe dy (2) shtojcat** - . Qëllimi i këtij Plani strategjik është paraqitja e një vizioni të përgjithshëm strategjik për adresimin dhe zgjidhjen e lëndëve të cilat janë me prioritet, përfshirë, lëndët që janë

kthyer në rigjykim, lëndët të cilat janë me prioritet të lartë, në bazë të ligjeve përkatëse, lëndët të cilat janë punuar në gjykata dhe ka kaluar dy vite për të cilat nuk ka filluar trajtimi i tyre, si dhe lëndët tjera për të cilat duhet ndërmarrë veprime të përshpejtuara e të cilat ekzistojnë nëpër gjykatat e Kosovës. Pasi që trajtimi i lëndëve brenda afatit të arsyeshëm kohor i përcaktuar me legjislacionin në fuqi dhe me instrumentet ndërkombëtare të zbatuara, si dhe zvogëlimi i lëndëve është një nga çështjet më kritike me të cilat përballet gjyqësori i Kosovës

Synim i këtij Planit strategjik është zhvillimi i një qasjeje praktike, me qëllim të adresimit të çështjes së zvogëlimit përkatësisht zgjidhjes së lëndëve që kanë një afat më të gjatë të pritjes si dhe atyre që përcaktohen për nga natyra si lëndë me prioritet.

Në këtë plan strategjik janë përcaktuar objektivat e gjyqësorit që synojmë të arrihen, janë përcaktuar edhe përgjegjësitë kryesore të kryetarëve të gjykatave, gjyqtarëve dhe administratorëve në lidhje me zbatimin e këtij plani. Përveç kësaj, në këtë plan është përcaktuar edhe mekanizmi mbikëqyrës në lidhje me zbatimin e strategjisë e që do të bëhet përmes raportimeve të kryetarëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Pjesë e strategjisë është edhe plani i veprimit në të cilin janë detajuar veprimet dhe masat që duhet të ndërmerren sipas strategjisë, përveç kësaj në planin e veprimit përcaktohen edhe personat përgjegjës për realizimin e këtyre veprimeve si dhe raportimi nga ana e tyre. Shtojcë tjetër është analiza e statistikave vjetore për vitin 2019, 2020 dhe 2021, në të cilën është paraqitur gjendja e secilës gjykatë për vitet e caktuara.

KATALOGËT I POZITAVE DHE PËRSHKRIMIT TË VENDEVE TË PUNËS PËR TË PUNËSUARIT E GJYQËSORIT

KÇN gjatë realizimit të objektivave të tij në pajtim me planin e punës dhe legjislacionin në fuqi ka hartuar, finalizuar dhe rekomanduar për miratim në Këshill edhe dy(2) katalog.

Katalogët e rekomanduar janë miratuar në Këshill dhe janë si në vijim:

1. **Katalogu i Pozitave dhe Përshkrimit të Vendeve të Punës për të Punësuarit e Gjyqësorit-** përmes këtij katalogu synohet që të specifikohet përshkrimi i detyrave të punës për të gjithë punonjësit e administratës së gjyqësorit më qëllim që sistemi gjyqësor të ketë një administratë sa më efikase dhe efektive dhe që të kërkohet llogaridhënie për secilën pozitë në rast se punonjësit e administratës nuk i përmbushin detyrat e punës sipas përshkrimit të vendit të punës në pajtim me këtë katalog.

Në katalog përfshihen tridhjetë e shtatë (37) pozita të punonjësve të administratës së gjykatave të Republikës së Kosovës, ashtu që në secilën pozitë parashihet: emri i institucionit; titulli i vendit të punës; kategoria funksionale; grada e vendit të punës; lloji i vendit të punës; Departamenti/Njësia; mënyra e raportimit; vlerësimi i performancës dhe vendndodhja përfshirë qëllimin e vendit të punës; një përshkrim të detyrave të punës; përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe nivelit të performancës; nivelin e përgjegjësisë financiare; aftësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për vendin e punës; kualifikimet arsimore dhe profesionale; përvojën e punës që kërkohet për vend të punës si dhe karakteristikat e pazakonta të mjedisit të punës nëse ka.

2. **Katalogu për Plotësimin dhe Ndryshimin e Katalogut të Pozitave dhe Përshkrimit të Vendeve të Punës për të Punësuarit e Gjyqësorit** – në pajtueshmëri me Ligjin për Gjykatën Komerciale është marrë iniciativë në hartimin dhe shqyrtimin e Rregullores Nr. 07/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Komerciale, e cila është miratuar në Këshill, pastaj në pajtueshmëri me këtë rregullore dhe Ligjin për gjykatën Komerciale dhe me qëllim të përmbushjes së e kërkesave ligjore, Komisioni përsëri ka iniciuar hartimin dhe shqyrtimin e Rregullores Nr. 09/2022 për Rekrutimin dhe Emërimin e Këshilltarit Ligjor në Gjykatën Komerciale, e cila po ashtu është miratuar në Këshill. Me qëllim të funksionalizimit të

Gjykatës Komerciale dhe jetësimit të Rregullore Nr. 09/2022 për Rekrutimin dhe Emërimin e Këshilltarit Ligjor në Gjykatën Komerciale në praktikë, komisioni e ka hartuar dhe shqyrtuar katalogun për plotësimin dhe ndryshimin e Katalogut të Pozitave dhe Përshkrimit të Vendeve të Punës për të Punësuarit e Gjyqësorit.

Me këtë pozitë, katalogut të Pozitave dhe Përshkrimit të Vendeve të Punës për të Punësuarit e Gjyqësorit, të miratuar me vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës numër, KGJK.nr. 171/2022, të datës 5 maj 2022 i është shtuar edhe përshkrimi për vendin e punës për pozitën e Këshilltarit Ligjor apo Kreut të Njesisë në Gjykatën Komerciale. I cili me këtë plotësim dhe ndryshim të katalogut bazë e mundëson publikimin e shprehjes së interesit për këtë pozitë, pra fillimin e procedurave për përmbushjen e kërkesës ligjore që buron nga Ligji për Gjykatën Komerciale.

Edhe këtu sikur tek katalogu bazë për pozitën në fjalë parashihet: emri i institucionit; titulli i vendit të punës; kategoria funksionale; grada e vendit të punës; lloji i vendit të punës; Departamenti/Njësia; mënyra e raportimit; vlerësimi i performancës dhe vendndodhja përfshirë qëllimin e vendit të punës; një përshkrim të detyrave të punës; përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe nivelit të performancës; nivelin e përgjegjësisë financiare; aftësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për vendin e punës; kualifikimet arsimore dhe profesionale; përvojën e punës që kërkohet për vend të punës si dhe karakteristikat e pazakonta të mjedisit të punës nëse ka.

PËRFUNDIM

Komisioni për Çështje Normative, në pajtim me Planin e punës së Këshillit për vitin 2022 dhe objektivat strategjike të mbështetura në Strategjinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitet 2020-2022, ka hartuar dhe miratuar planin e punës së tij. KÇN në plan të punës ka paraparë gjithsejtë njëzet e një (21) akte normative për hartim, shqyrtim, finalizimin dhe rekomandim për miratim në Këshill.

Nga një njëzet e një (21) akte normative të parapara në plan të punës, prej tyre ka shqyrtuar, finalizuar dhe ka rekomanduar për miratim në Këshill trembëdhjetë (13) akte normative. Ndërsa tetë (8) akte normative kanë mbetur jashtë realizimit të objektivit për vitin 2022, prej të cilave dy (2) akte nuk ka mundur t'i finalizoj për shkaqe objektive pasi që për një akt normativ, Këshilli me vendim e ka autorizuar Komisionin për Administrimin e Gjykatave të merret me atë çështje, ndërsa akti tjetër normativ është në finalizim e sipër.

Edhe pse në shikim të parë duket se KÇN nuk ka mundur t'i përmbush objektivat e tij, në realitet KÇN i ka tejkaluar pritjet dhe objektivat për vitin 2022, ka rekomanduar për miratim në Këshill gjithsejtë njëzetë e katër (24) akte normative, prej të cilave edhe njëmbëdhjetë (11) akte normative nga të cilat: pesë (5) rregullore, një (1) udhëzimin administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ, dy (2) udhëzues, një (1) ndryshim dhe plotësimi katalogut bazë dhe dy (2) strategji të cilat në vete ngërthejnë edhe planin e veprimit për realizimin e strategjisë, të cilat kanë derivuar nga vendimet e Këshillit dhe legjislacioni i miratuar gjatë këtij viti. Te gjitha aktet e rekomanduara për miratim nga KÇN janë miratuar në Këshill.

Më tej, KÇN gjatë këtij viti përveç akteve që ka finalizuar dhe rekomanduar për miratim në Këshill, ka proceduar në konsultim publik dy (2) rregullore si dhe ka shqyrtuar dhe ka arritur deri në fazën e finalizimit të Katalogut të pozitave dhe përshkrimit të vendeve të punës për të punësuarit e Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Katalogut të pozitave dhe përshkrimit të vendeve të punës për të punësuarit e Njësisë të Inspektimit Gjyqësor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Komisioni ka hartuar Planin e Punës për vitin 2023, i cili ka prioritet hartimin dhe rekomandimin për miratim të një mori aktesh normative, të cilat do të lehtësojnë punën e Këshillit dhe gjyqësorit në përgjithësi.

Në emër të KÇN, falënderojmë kryesuesin e Këshillit, anëtarët dhe sekretaren e komisionit, anëtarët e Këshillit, secilin gjyqtar pjesëmarrës në grupe punuese, drejtorët dhe të gjithë zyrtarët e tjerë të Sekretariatit të Këshillit dhe Njesisë për Inspektim Gjyqësor, partnerët ndërkombëtar si : BE, KE, USAID dhe OSBE, për kontributin, mbështetjen profesionale dhe mbështetjen me punëtori gjatë hartimit të akteve normative, si dhe shoqërinë civile, mediat dhe çdo grupi tjetër te interesit për komentet, rekomandimet dhe sugjerimet e tyre.

Prishtinë, 30 janar 2023.

Drita Rexhaj,

Kryetare e KÇN-së,